



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo – Republic of Kosovo**  
*Kuvendi – Skupština – Assembly*

---

**Legjislatura V**  
**Sesioni pranveror**

**Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri**

Mbledhja nr. 97/2017

Prishtinë, më 2.5.2017, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-1

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Muhamet Mustafa, kryetar, Sasha Milosavljeviq, zëvendëskryetar i dytë, Besim Beqaj, Raif Qela, Blerim Grainca, dhe Enver Hoti, anëtarë.

**Munguan:** Glauk Konjufca, zëvendëskryetar i parë, Sala Berisha-Shala, Fatmir Rexhepi, Rustem Berisha dhe Duda Balje, anëtarë.

**I ftuar:** Krenar Bujupi, ushtrues detyre i kryetarit të bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë.

**Pjesëmarrës të tjerë:** Arsim Janova, Besim Sejfiqaj, Petrit Pepaj, Gani Buçaj dhe Ymer Fejzullahu –ZRRE, Elteva Malushaj – LVV, Blerta Aliu – KDI, Sanije Berisha – OSBE, Albulena Avdiu – Ekonomia online dhe Albulena Mavaraj – Epoka e Re.

**Stafi Mbështetës i Komisionit:** Armend Ademaj, Besim Haliti, Muhamet Morina, Veton Raci dhe Nurie Morina.

**Mbledhjen e kryesoi: Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit.**

**Në këtë mbledhje u propozua ky**

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i Raportit Vjetor të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë – ZRRE për vitin 2016;
3. Të ndryshme.

*Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.*

## 1. Miratimi i rendit të ditës

*Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.*

## 3. Shqyrtimi i Raportit Vjetor të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë – ZRRE për vitin 2016

**Kryetari** tha se kemi marrë raportin, dhe është një raport më të dhëna të nevojshme që pasqyron aktivitetin e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë dhe ftoi z. Krenar Bujupi, të bëjë prezantimin e raportit.

**Krenar Bujupi, ushtrues detyre i kryetarit të bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë,** E paraqet ekspozenë e raportit, duke i paraqitur të arriturat dhe sfidat e këtij institucioni si vijon: raporti është i përgatitur ndryshe nga raportet paraprake, raporti është i ndarë në dy pjesë, pjesa e parë e raportit përshkruan aktivitetet e ZRRE-së të zhvilluara gjatë vitit 2016, kurse pjesa e dytë e raportit përshkruan sektorin e energjisë. Aktivitetet e ZRRE-së në vitin 2016, kanë qenë të bazuara në planin e punës i cili është i bazuar në planin strategjik për vitet 2013-2017. Aktivitetet e Bordit të ZRRE-së kanë qenë të orientuara në përmbushjen e suksesshme të kompetencave dhe detyrave të përcaktuara me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë dhe objektivat e përfshira në planin e punës. Bordi i ZRRE-së gjatë vitit 2016 ka mbajtur 7 (shtatë) procese të diskutimit publik dhe gjithsej 14 mbledhje publike, në të cilat janë marrë 126 vendime që kanë të bëjnë me: Monitorimin e tregut dhe aktivitetëve të sektorit të energjisë, Liberalizimin e tregut të energjisë, Rregullimin e çmimeve; Licencimin e aktivitetëve të energjisë në Kosovës, Autorizimin e ndërtimeve të kapaciteteve të reja të gjenerimit të energjisë nga Burimet e Ripërtërishme, Mbrojtjen e konsumatorëve, Aprovimin e rregullave, metodologjive dhe dokumenteve të tjera të sektorit të energjisë, Çështje të tjera në kuadër të përgjegjësisë së tij. ZRRE-ja gjatë vitit 2016, po ashtu ka kryer edhe monitorimin e ndërmarrjeve të licencuara. Monitorimi është kryer në përputhje me përgjegjësitë e ZRRE-së të dhëna me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë dhe është bërë me qëllim të vlerësimit të nivelit të përmbushjes së obligimeve të dala nga licencat përkatëse dhe korniza rregullatore, nga ana e të licencuarve dhe identifikimi i mangësive dhe çështjeve që kërkojnë zgjidhje në drejtim të përmbushjes së obligimeve. Pas hyrjes në fuqi të Ligjeve për sektorin e energjisë vitin e kaluar, ZRRE është duke punuar në drejtim të hartimit të kornizës rregullatore brenda afateve të caktuara. Liberalizimi i tregut të energjisë elektrike i reflektuar në Udhëzuesin për Liberalizimin e Tregut i aprovuar në fund të vitit 2016 nga Bordi i ZRRE-së është i një rëndësie të veçantë për të implementuar ligjet e reja në përputhje me pakon e tretë të direktivave energjetike të Bashkimit Evropian. ZRRE-ja duke u mbështetur në dispozitat ligjore në fuqi, ka licencuar edhe dy kompani të tjera për furnizim me energji elektrike “HEP - KS SH.P.K” dhe “GSA ENERGJI SH.P.K.” për aktivitetin e furnizimit me energji elektrike për periudhën prej 5 (pesë) vitesh, mbështetur në kritere dhe procedura që sigurojnë trajtim të barabartë dhe transparent në përputhje me legjislacionin në fuqi. Bordi ka vendosur që për vitin 2016 të ruajë të njëjtat tarifa dhe strukturën tarifore për konsumatorët familjarë, ndërsa për konsumatorët industrial dhe komercial ka bërë ulje të tarifave nga 7.17% deri në 8%, bazuar në kostot e shërbimit për këto kategori të konsumatorëve. Gjatë vitit 2016 ka pasur një shtim të aplikimeve për marrjen e autorizimit për ndërtim të kapaciteteve të reja gjeneruese të paraqitura në ZRRE nga subjektet e ndryshme juridike. Janë pranuar 19 aplikacione për ndërtim të gjeneratorëve të rinj dhe 12

kërkesa për shndërrimin e autorizimit preliminar në autorizim final. Në përputhje me legjislacionin në fuqi Bordi ka vendosur që Tarifatat e reja të energjisë termike të NQ Termokos të jenë mesatarisht 5% më të ulëta se ato të sezonit të kaluar. Bordi i ZRRE-së, i ka dhënë një rëndësi dhe prioritet të veçantë komunikimit me publikun e gjerë. Për këtë qëllim janë mbajtur një numër i madh i takimeve publike, ku ZRRE ka sqaruar ndryshimet e legjislacionit sekondar. Korniza rregullatore në sektorin e energjisë, ashtu si dhe Ligjet respektive të energjisë do të reflektojnë kërkesat e Pakos së tretë të në fushën e energjisë. Duhet të theksohet se i tërë harmonizimi i legjislacionit është duke u bërë në bashkëpunim dhe komunikim të vazhdueshëm me Sekretariatit e komunitetit të energjisë. Duhet të theksohet se u është kushtuar shumë rëndësi rekomandimeve të vitit të kaluar të dhëna nga komisioni parlamentar, këto rekomandime janë përmbushur në tërësi dhe janë të reflektuara në raportin i cili gjendet para jush.

**Kryetari** tha se raporti në përgjithësi ka vijuar një linjë të përmirësimit në përmbajtje të informacionit duke marrë parasysh diskutimin dhe rekomandimet nga ana e Komisionit nga viti i kaluar, mund të konstatojmë se kemi përmirësim në këtë sektor, si në prodhim, në konsum e po ashtu edhe në investime. Çështje brengose është anëtarësimi i KOSTT-it në ENTSO-E e cila nuk varet nga ZRRE, por me shumë është çështje politike. Humbjet e larta po ashtu janë çështje problematike dhe kjo është e papranueshme, i dimë arsyetimet politike, po nuk mund të pranojmë që edhe me tutje të kemi konsumatorë të cilët nuk paguajnë shpenzimet energjetike të shpenzuar. Faturimi po ashtu është dukuri e cila kërkojmë që të zgjidhet dhe t'i vije fundi sa më shpejt, për këtë ne do të japim mbështetjen tonë. Është për t'u përsëritur që për herë të parë është cekur indeksi i cilësisë sepse cilësia edhe është obligim i ZRRE-së, kërkojmë që përveç indekseve të cilësisë që të marrim edhe kënaqësinë edhe të konsumatorëve. Çështja e problemit me ankesa të konsumatorëve, unë shoh se ju jeni përgjigjur në një pjesë të madhe prej tyre, por problemi ende qëndron se pak qytetar e dinë se duhet që ankesat të drejtohen te ju dhe shumica ankesat i drejtojnë tek operatorët dhe kjo duhet të zgjidhet, kërkojmë nga ju që të kontrolloni faturimet edhe pa u ankuar konsumatorët në mënyrë që të shihen problemet me furnizim.

**Blerim Grainca** tha se nga raporti i juaj thuhet se ka pasur shkurtime buxhetore prej 7-8% nga ana e Qeverisë. Më intereson ta di se sa ka ndikuar ky shkurtime i buxhetit në punët operative ditore? A ka mbetur ndonjë projekt pa u realizuar si rezultat i këtij shkurtimi buxhetor? Nëse i referohemi të hyrave të ZRRE, rezulton se ju keni të hyra diku rreth 1 milion e 800 mijë euro, kurse shpenzime keni rreth 600 mijë euro, që i bie se 1 milion e 200 mijë keni suficit për çdo vit i cili bartet, a mund të menaxhohet me mirë në mënyrë që të mos barten në vitin tjetër dhe të alokohen për qëllime të tjera? Më intereson edhe nënshkrimi i memorandumit që është bërë në Vjenë për bashkëpunim me Ballkanin Perëndimor, rezulton se vetëm zyra juaj nuk e ka nënshkruar, a nuk është bërë ky nënshkrim për shkak të konspiracioneve politike apo ka pasur vërejtje të tjera? Po ashtu ankesat e konsumatorëve shoh se vetëm 50% të tyre ju keni dhënë përgjigje, a është arsye mungesa e kapaciteteve që nuk u jeni përgjigjur apo keni ndonjë problem nga ana menaxheriale apo organizative? Dhe në fund me intereson ndryshimi i fundit i tarifave sa ka ndikuar në çështjet e furnizimit, pakënaqësitë e qytetarëve dhe uljes së problemeve sa ka ndikuar a keni ndonjë studim apo analizë?

**Besim Beqaj**, tha se raporti është shembull edhe për agjencitë e tjera të pavarura se si duhet të prezantojnë para Kuvendit. Në këtë raport janë 2-3 elemente që duhet cekur nga një

këndvështrim tjetër, e para është se përmes rregullatorit është krijuar një mundësi që liberalizimi nuk parasheh asnjë lloje kufizimi, që është diçka që unë besoj do ta ngritë konkurrencën dhe kjo për konsumatorin është element shumë i rëndësishëm. Çështje tjetër është që gjatë javës së kaluar së bashku me kryetarin e Komisionit kemi qenë në Bruksel, kemi pasur takimin e parë të Penumit të parlamenteve të vendeve anëtare të Komitetit të Energjisë! Edhe atje kemi ngritur shqetësimin rreth anëtarësimit të KOSTT-it në ENTSO-e respektivisht funksionalizimin sepse ne realisht jemi të anëtarësuar, por është anëtarësim i cili nuk po jep rezultate ende. Se shpejti ne do dalim me një raport i cili tregon gjendjen e funksionimit të bashkëpunimit energjetik në Evropën Perëndimore, ku janë përcaktuar dy raportues, ku unë do të jem nga vendet anëtarë nënkruese do të raportoj për sistemin energjetik dhe bashkëpunimin energjetik me vendet e Ballkanit dhe do të jetë një deputet i Parlamentit Evropian, i cili është pjesë e grupit që trajton çështjet e energjisë. Çështje tjetër, por që nuk është pjesë e raportit, e që dua ta cek, janë edhe trendet të cilat janë duke shkuar drejt tarifave nxitëse dhe pashë që ne po shkojmë drejtë energjisë së ripërtëritshme sepse, siç e dini, tani në BE po diskutohet për energjinë e gjelbër dhe iniciativat e reja deri në vitin 2030 po shkojnë drejtë energjisë së gjelbër. Atje ka debate për modifikimin e tarifave nxitëse rreth energjisë së ripërtëritshme dhe dua ta di a keni menduar edhe ju në këtë aspekt. Sa i përket licencave kisha kërkuar nga ju që licencat që janë në proces dhe të cilat merren duhet të monitorohen sa më shpejt për fillimin e investimeve dhe nëse nuk kanë kapacitete me filluar me investime duhet të ja heqim licencat të mos lejojmë këtë proces me vazhduar deri në pafundësi.

**Raif Qela** tha se ky raport si i tillë nuk ka vërejtje, dua të ndalem me shumë në çështjet që kanë të bëjnë me punën e ZRRE dhe të sektorit. Konsideroj që përgjithësisht puna e ZRRE-së dhe sektorit të energjisë është përmirësuar dukshëm, por akoma ka çështje që mund të përmirësohen duke u nisur nga monitorimi i operatoreve të furnizimit me energji elektrike. Po ashtu përsëritet ndëshkimi i njërit nga operatorët i cili në kundërshtim me atë se nuk është dashur ta ndërprerë energjinë dhe ka raportuar se energjia është ndërprerë për shkak të planifikimeve dhe jo për shkaqe të tjera. E inkurajoj ZRRE-në që masa të tilla ndëshkuese të marrë sa herë ka nevojë, por që të bëjë këtë duhet të shtohen masat e monitorimit, ndoshta njëra nga arsyet se pse nuk ka monitorim sa duhet është se ndoshta ka mungesë të kapaciteteve njerëzore dhe nëse ka duhet të kërkohet mbështetje edhe nga ana e këtij Komisioni. Sa i përket energjisë së ngrohjes në Prishtinë është përmirësuar dukshëm dhe si i tillë ka ndihmuar edhe që i tërë sektori të jetë me mirë, konsumatorët paguajnë në bazë të metrave katrore, por mendoj se është mirë që konsumatorët të mos paguajnë për ditët që janë të ngrohta dhe kur nuk kanë nevojë për shfrytëzim të ngrohjes. I gjithë stafi në ZRRE paska 33 punëtorë dhe mendoj se si agjenci duhet të keni me shumë kapacitete njerëzore, por për këtë ju duhet që vetë të jeni më të zëshëm. Lidhur me atë se nga taksat e licencimit të hyrat janë trefish me shumë se sa shpenzimet buxhetore të realizuara të ZRRE-së, nga opinioni i juaj a mendoni se këto taksa të ulen dhe në çfarë sasive? Me intereson vetëm opinioni i juaj pasi që e di se kjo nuk është punë e juaj. Lidhur me tarifën edhe pse nuk i përket raportit të këtij viti jam i bindur se do keni ankesa nga konsumatorët për faturat dhe mendoj se ju duhet të sqaroni opinionin publik dhe vetë komisionin për këto tarifa të reja, sepse edhe për ne nuk është mjaft e qarte, pse të jetë sasia 7 me 3 dhe jo shembull 6 me 4, a do të ndryshojnë të hyrat e përgjithshme të operatorit të shpërndarjes nëse janë ndryshuar tarifën? Duke e marrë mesataren e shpenzimeve të viteve të kaluara, sa ka pasur operatori të hyra në vitin e kaluar dhe sa do të këtë në këtë vit për shpenzime të njëjta?

**Enver Hoti:** Kam një pyetje direktë për z. Krenar Bujupi, më intereson ta di që sa kohe je ushtrues detyre dhe edhe sa do vazhdosh kështu dhe a ke pengesa në ushtrimin e funksionit? Importi dhe eksporti i energjisë elektrike për vitin 2016, ju e keni paraqitur këtu një aktivitet bukur të ngjeshur të këtij raporti dhe me bërë në sy një çmim: energjia elektrike e importuar për vitin 2016 është bërë për 47.62 euro për megavat, ndërsa eksporti është bërë për 29 euro, me intereson një sqarim me detaj këtu. Nuk keni bashkëngjitur asnjëherë ndonjë raport të ndonjë auditimi, a keni auditim apo si qëndron puna? Pastaj lidhur me një shpërthim që ka ndodhur në qershor të vitit 2014 në KEK, e di që janë organet kompetente që merren me atë punë, por ne nuk kemi marrë asnjë sqarim rreth këtij rasti dhe a mund të na thoni arsyet se pse ndodhi kur e kemi parasysh se ka pasur pasojë edhe në njerëz edhe në aspekte të tjera.

**Krenar Bujupi, ushtrues detyre i kryetarit të bordit të ZRRE-së,** ju faleminderit së pari nga ana e anëtarëve të Komisionit për fjalët se raporti është mirë dhe po ashtu kemi një përmirësim të sektorit të energjisë dhe përmirësim të punës së ZRRE-së, më duhet ta ndaj këtë mendim me ju dhe po ashtu ta falënderoj stafin e ZRRE-së. Mandej iu përgjigj pyetjeve më radhë: Ju e paraqitet si problem tek ne, mirëpo ne e kemi paraqitur shumë herë këtë problem për punën e buxhetit dhe numrin e stafit. Arsyeja pse të hyrat vetjake kanë mbetur për një milion është se gjithmonë rregullatori ka kërkuar që buxheti i rregullatorit të rritet sa i përket stafit, kur rritet stafi rritet edhe buxheti, mbledhen të hyrat e elokuara. Përgjigjja tash me thënë edhe e Parlamentit në këtë rast ka qenë që jo të na lejohet neve që t'i rrisim të hyrat në buxhetin tonë d.m.th. t'i rrisim shpenzimet tona, por e kanë futur në Ligj që do të na marrin edhe pjesën e mbetur nga buxheti jonë. Kështu që neve nuk e dimë se nga cila anë me luftuar ZRRE-ja më shumë, por realisht edhe ne jemi të mendimit se nëse vazhdon kjo situatë dhe nuk kemi mundësi si ZRRE për me rritur stafin për me e rritur buxhetin, atëherë si masë e fundit do të jetë që t'i zvogëlojmë të gjitha taksat të cilat i marrim nga të licencuarit për shkak se deri tash nuk kanë shkuar në Qeveri, janë bartur, mirëpo ajo bartje ka qenë e implikuar shumë. Por realisht nevoja e rregullatorit për monitorime për përgjegjësitë e reja që i ka nevojitet edhe 10 persona të tjerë në rregullator për t'i mbaruar të gjitha detyrat si duhet me kualitetin e duhur. Humbjet e larta zoti profesor, jemi shumë të pajtimit që ka qenë kjo ndër pikat më stresuese të ZRRE-së dhe kjo ka qenë një prej pikave më konfliktuozë që e kemi pasur edhe me të licencuarit sepse siç e dini juve ne kemi refuzuar që t'i pranojmë këto humbje në faturë të konsumatorit. Mirëpo këto humbje, siç kemi biseduar edhe më herët, janë të lidhur edhe me mekanizmat e tjerë dhe me institucione të tjera shtetërore. Për standardet e cilësisë kjo është në vazhden e monitorimit, por jemi duke u munduar që të gjitha këto standarde t'i paraqesim në monitorime ku pastaj do të shihen në monitorime, më pëlqej ideja e matjes së kënaqësive të konsumatorëve besoj mund të fillojmë një gjë të tillë që ta bëjmë një lloj indikator të cilin mundemi me mbajt gjatë vitit në vit dhe me e bërë njëfarë lloj krahasimi. Për planin e mirëmbajtjes, ndoshta ju keni biseduar për çështjen e ndërprerjeve të planifikuara. Mirëpo do të kisha thënë që rregullatori, sa i përket ndërprerjeve gjithmonë poenta e rregullatorit ka qenë përmirësimi i situatës. Ne kemi pasur një kohë dhe jo transparencë, sa i përket asaj se ku është duke u mbajt mirëmbajtja, ku është t'u ndal rryma, ku janë duke u bërë reduktime d.m.th. e gjithë fuqia e rregullatorit që të sigurohet së pari transparenca që të kuptojmë së pari se ku po dalim, normalisht që gjatë kësaj transparence të madhe ju i keni parë që ata është dashtë me e qit çdo ditë informacionin se ku po ndalet rryma. Ndërprerja e punimeve, janë një mori masash ku janë marrë, ne e kemi për detyrë dhe do të fillojmë sa më shumë inspektime sa i përket konsumatorëve dhe faturimeve të tyre dhe cilësisë në këtë rast të licencuarve për faturim. Memorandumi nuk është nënshkruar sepse

memorandumi i paraqet disa obligime të cilat ne, si Kosovë, nuk kemi mundësi se si t'i përmbushim, pa qenë KOSST-i si zonë kontrolluese e pavarur d.m.th. kjo ka qenë arsyeja. Sa i përket anëtarësimit të KOSST-it, zgjedhja teknike ka qenë në fazën e marrëveshjes në mes të Shqipërisë edhe të Kosovës që të shikohet mos po gjendet ndonjë mënyrë e shfrytëzimit të kapacitetit në mes të Shqipërisë-Kosovës, në mes të dy shteteve. Mirëpo kjo po bëhet pak më e vështirë duke pasur parasysh që Shqipëria është pjesë e mekanizmave të ENTSO-E-së, më përpara s'ka qenë, por tani është dhe tani është ndryshe krejt. Për tarifatat nxitëse nëpër të gjithë Evropën flitet më shumë për premiume në tarifa se sa për tarifatat nxitëse, mirëpo më duhet të them se këto janë shtete të cilat kanë avancuar sa i përket zhvillimit të industrisë dhe mbasi kanë dhënë subvencione për të mëdha, mandej janë zvogëluar, ne i kemi pasur një të mirë se në kohën kur tarifatat nxitëse nuk kanë qenë shumë të mëdha dhe sistemi i tarifave nxitëse ka filluar tani vetëm kur i kemi parë që shumë probleme kanë dalë nga shtetet e tjera. Në monitorimin gjithmonë jemi tani ndoshta duhet të them z. Beqaj ka qenë i këqyrë më shumë në monitorim sa ka qenë ministër, tani jemi duke e bërë monitorimin e investimeve kemi raporte, kemi bërë monitorimin e investimeve, këto që janë mbaruar i kemi edhe raportet, gjendja është mirë, mirëpo ka probleme financiare më shumë. Ngrohja realisht na ka ndihmuar në sistemin tonë energjetik, kemi kaluar në 24 orë ngrohje, por e vërteta është që kemi filluar pak me u ankuar e kemi pasur një ndryshim shumë të madh d.m.th. prej një periudhe që u ankoheshin që nuk kemi ngrohje tani u ankuam shumë nga të nxehtit, por ngrohjen jemi duke u mundur që ta shtyjmë që të shkoj sa më shumë nga konsumi. Unë jam nga 23 shtatori ushtrues i detyrës së kryesuesit të bordit, për shkak se afati i z. Enver Halimi 5 vjeçar ka përfunduar, sipas Ligjit për Rregullatorin e Energjisë në momentin kur mbetet bordi pa kryesues, atëherë kryesimin e bordit e merr anëtari më i vjetër në bord i cili kam qëlluar unë për nga stazhi në bord, dhe neve nuk kemi kufizime ligjore sa i përket mandatit të kryesuesit të mandatit të ushtruesit të detyrës, por kemi kufizime ligjore sepse kam kufizime ligjore në mandatin tim personal, d.m.th. mandati i anëtarit të bordit më përfundon më 15 maj 2017 dhe më 15 maj 2017 përfundon edhe mandati i kryesuesit d.m.th. edhe kryesuesi i kalon anëtarit më të vjetër në bord tjetër i cili është në vazhdim. Për auditim bëhet prej auditorit të përgjithshëm d.m.th. raportet e auditimit jepen çdo vit, tani akoma nuk janë bërë. Desha me u lidh pak me tarifa dhe me importin, pikërisht 7 me 3, është për atë që neve kemi shumë teprica gjatë natës sepse kemi më shumë mungesa gjatë ditës, duke e pasur parasysh se po e shesim eksportin kaq lirë neve më shumë kemi pasur dëshirë që me i dhënë konsumatorit mundësinë për me e kursye frakturën e vet se sa me e dërguar këtë eksport dika tjetër, sepse eksporti gjatë natës në çdo vend është i lirë dhe kjo është bërë raporti i madh në mes ditës dhe natës. Duke folur për të ardhurat raporti ekziston ku i kemi paraqitur të gjitha të dhënat të cilat i kemi marrë nga tarifatat e kaluara nga vitet e kaluara. Kur t'i mbledhur të gjitha megavatet të cilët i kemi pasur këtu kilovatët e shpenzuar të energjisë elektrike të konsumatorit të shumëzuara me tarifatat të cilat kanë qenë në vitin e kaluar, i kemi marrë 126 milionë e 820 mijë, ndërsa me tarifatat e reja d.m.th. se ne nuk kemi bërë kalkulime vetëm kemi marrë dhe kemi thënë se tash tarifatat e njëjta duhet me qenë sikurse në vitin e kaluar, d.m.th. kur i numëron kilovatët e njëjta me tarifatat e reja neve, po na dalin 126 milionë 587 mijë d.m.th. dalin 200 mijë më pak se vitin e kaluar d.m.th. i licencuar merr më pak të hyra se sa vitin e kaluar për të njëjtin sasi. Për çështje të importit dhe eksportit e kemi problemin që importojmë gjatë ditës kur e kemi çmimin e lartë të energjisë elektrike, në krejt rajonin atëherë importojmë ne, ndërsa në të vetmet raste kur eksportojmë në shumicën e rasteve gjatë natës, për atë të thashë që eksportin dhe importin kemi edhe natën edhe ditën.

*Pas debatit, Komisioni me 5 (pesë) vota për dhe 1 (një) kundër nxori këtë:*

*R e k o m a n d i m*

*1. Të miratohet Raporti vjetor i Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE), për vitin 2016, me rekomandimet si vijon:*

- a) ZRRE-ja të ndërmarrë të gjitha masat e domosdoshme në zvogëlimin e humbjeve komerciale, duke përfshirë faturimin dhe inkasimin e energjisë së shpenzuar nga të gjithë konsumatorët, pa marrë parasysh vendndodhjen e tyre, përkatësinë regjionale dhe etnike. Çështjet politike të ndërlidhura me këtë duhet të zgjidhen shpejt në mënyrë që konsumatorët e përgjegjshëm mos të bartin barrën që të paguajnë edhe për konsumatorët të cilëve nuk u faturohet energjia ose konsumatorët që abuzojnë me energji, prandaj institucionet duhet të kenë përgjegjësinë, në mënyrë që humbjet të mos iu faturohen konsumatorëve të përgjegjshëm;*
- b) ZRRE-ja të vazhdojë angazhimin për rritjen e standardeve të cilësisë së furnizimit me energji elektrike nga operatorët;*
- c) ZRRE-ja të hulumtojë disponimin e konsumatorëve në mënyrë të rregullt nga një kontraktor i pavarur;*
- d) Inkurajohet ZRRE-ja që në koordinim me organet tjera të insistojë që KOSTT-i të marrë statusin si një entitet i barabartë në kuadër të operatorëve rajonalë dhe ENTSO-E, si dhe të marrë në konsideratë masat e reciprocitetit për të arritur këto qëllime;*
- e) ZRRE-ja të fuqizojë monitorimin e operatorëve energjetikë, me theks të veçantë investimet e realizuara;*
- f) ZRRE-ja në vazhdimësi të shqyrtojë ankesat e konsumatorëve edhe atëherë kur ato nuk i janë drejtuar ZRRE-së, por vetëm operatorëve energjetikë;*
- g) ZRRE-ja të ashpërsojë përgjegjësinë e operatorëve për transparencë dhe llogaridhënie dhe informim korrekt të konsumatorëve dhe opinionit për ndërprerjet e energjisë, meremetimet dhe investimet lidhur me to, duke tejkualuar dhe duke mos përsëritur situatën që e kishim në nëntor dhe dhjetor të vitit 2016.*

*2. Arsyetimin e Raportit me rekomandime do ta paraqesë deputeti Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit.*

**3. Të ndryshme**  
**Çështjet vijuese**

**Mbledhja përfundoi në ora 12:30.**

**E përgatiti:**  
**Njësia për Mbështetjen e Komisionit.**

**Kryetar i Komisionit,**  
-----  
**Muhamet Mustafa**